

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Naklofen® 75 mg/3 ml tretësirë për injeksion diklofenak natrium

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'u bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njëjta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit tuaj.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Naklofen dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Naklofen
3. Si të merrni Naklofen
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Naklofen
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË NAKLOFEN DHE PËR SE PËRDORET

Naklofen është medikament josteroid, antiinflamator. Ka efekte antiinflamatore dhe të lirimit nga dhimbja. Mekanizmi kryesor i veprimit është frenimi i sintezës së prostaglandinës, molekula e cila shkakton inflamacione, dhimbje dhe ënjtje. Përdoret për mjekimin e të gjitha llojeve të sëmundjeve reumatike dhe për lehtësimin e llojeve të ndryshme të dhimbjes.

Ky medikament përshkruhet për sëmundjet në të cilat janë të domosdoshëm efektet anitinflamatore të cilët lehtësojnë dhimbjen:

- sëmundjet inflamatore reumatike (artriti reumatoid, spondilartritis, artritetet tjerë),
- reumatizmi degenerativ i nyjeve dhe shpinës (artroza, spondiloza),
- artriti i shkaktuar me kristale (gihti, pseudogihti),
- reumatizmi jashtë nyjeve (periartriti, burziti, mioziti, tendiniti, sinoviti),
- gjendje të tjera të dhimbjeve (te lëndimet, procedurat dentale, pas ndërhyrjeve kirurgjike, në sulme të rënda të migrenës, dhe kolikat e veshkave dhe biliare).

2. PARA SE TË MERRNI NAKLOFEN

Mos e merrni Naklofen:

- nëse jeni alergjik në diklofenak natriumi, metabisulfit natriumi ose cilin do përbërës tjetër të këtij medikamenti (të specifikuar në seksionin 6), acidin acetilsalicilik dhe medikamentet tjera josteroide antiinflamatore,
- nëse keni përjetuar simptomet në vijim me përdorimin paraprak të medikamenteve josteroide antiinflamatore ose acidet acetilsalicilike: keni pasur përkeqësim të frymëmarrjes (astma bronkiale), urtikari, inflamacion të mukozës nazale (rinit akut), apo reaksion mbindjeshmërie me enjtje të papritur të buzëve dhe fytyrës, qafës, e mundshme edhe enjtja të duarve dhe këmbëve, dhimbje gjoksi ose mund te ndodh asfiksi dhe të ngjirurit e zërit (angioedema),
- nëse keni ose keni pasur ndonjëherë ulçerë në stomak ose në zorrë, gjakderdhje në lukth ose gjakderdhje gastrointestinale me simptoma siç është gjaku në jashtëqitje ose jashtëqitja e zezë apo vrimë në stomak,

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- nëse ndonjëherë keni pasur gjakderdhje në stomak, gjakderdhje gastrointestinale ose vrimë në traktin gastrointestinal pas përdorimit të medikamenteve josteroide antiinflatore (NSAID),
- nëse keni dëmtim të rëndë të mëlçisë ose veshkave,
- nëse jeni në tremujorin e fundit të shtatzënisë,
- nëse keni konstatuar sëmundje të zemrës dhe / ose sëmundje cerebrovaskulare, p.sh. nëse e keni insuficiencë mesatare të zemrës deri në serioze, nëse keni përjetuar sulm në zemër, sulm në tru, mini shok (TIA) ose bllokim të enëve të gjakut në zemër ose në tru ose operacion të pastrimit të bllokimit ose bajpas,
- nëse keni ose keni pasur probleme me qarkullimin e gjakut (sëmundja arteriale periferale).

Injeksionet nuk janë të përshtatshme për fëmijët.

Tregoni kujdes të veçantë me Naklofen

Bisedoni me mjekun tuaj ose infermieren para se të filloni të përdorni Naklofen.

- nëse keni pasur probleme me stomakun ose zorrët, siç është ulçera në lukth, jashtëqitjet e përgjakshme ose të zeza,
- në rast se ndonjëherë keni pasur dhimbje stomaku ose urth pas përdorimit të barnave kundër dhimbjeve ose barnave antiinflatore jo steroid,
- nëse keni kolit ulçeroz ose sëmundjen e Kron-it ngase sëmundja mund të përsëritet ose të përkeqësohet,
- nëse keni dëmtim të rëndë të mëlçisë ose veshkave, sëmundje kardiovaskulare,
- nëse keni epilepsi,
- nëse keni porfiri (çrregullim shumë i rrallë i metabolizmit të pigmenteve të gjakut),
- nëse keni astmë,
- nëse ju paraqiten ënjtjet në këmbë,
- nëse merrni medikamente të tjera për lehtësimin e dhimbjeve ose medikamente antiinflatore,
- nëse keni çrregullime të koagulimit të gjakut ose merrni medikamente të cilat përdoren për parandalimin e koagulimit të gjakut (antikoagulantët, fibrinolitikët),
- nëse jeni të moshuar.

Nëse ndonjëherë nga të lartëpërmendurat ka të bëjë me juve, kontaktoni mjekun tuaj ose infermieren para se të merrni Naklofen.

Tregoni mjekut tuaj nëse kohët e fundit i jeni nënshtruar ose do t'i nënshtroheni ndonjë operimi në stomak ose në traktin intestinal para se të pranoni/merrni/përdorni Naklofen, meqë Naklofen nganjëherë mund ta përkeqësojë shërimin e plagëve në zorrë pas operimit.

Tregoni mjekut tuaj para se të merrni diklofenak

- nëse jeni duhanpirës,
- nëse keni diabet,
- nëse keni anginë, koagulim të gjakut, tension të lartë të gjakut, kolesterol të lartë ose trigliceride të larta.

Efektet anësore mund të minimizohen duke përdorur dozat efikase më të ulëta në kohëzgjatje më të shkurtër.

Medikamentet siç është Naklofen mund të jenë të lidhura me rrezikun e shtuar nga sulmi në zemër (infarkti i miokardit) ose sulmi në tru. Çdo rrezik është edhe më i mundshëm tek dozat e mëdha dhe trajtimi i zgjatur. Mos e tejkaloni dozën e rekomanduar ose kohëzgjatjen e terapisë. Nëse, në çdo kohë gjatë pranimit/marrjes/përdorimit të Naklofenit përjetoni ndonjë shenjë apo simptomë të problemeve me zemër apo enë të gjakut, si dhimbje gjoksi, frymëmarrje të vështirësuar, dobësi ose të folur të paqartë, kontaktoni menjëherë mjekun tuaj.

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Reaksione serioze në lëkurë (disa nga ato janë fatale), inflamacion i shkallëzuar i lëkurës, nekroliza epidermale toksike (e rëndë, skuqje ekstenzive e lëkurës, skuqje dhe gërvishje e lëkurës) dhe sindroma Stevens Johnson (gjendje e sfiduar seriozisht e lëkurës, gojës, syve dhe organeve gjenitale), shumë rrallë paraqiten së bashku me përdorimin e NSAID-eve. Duket se pacientët iu nënshtrohen rrezikut më të madhë gjatë marrjes së hershme të terapisë; prandaj, trajtimi duhet të ndërpritet me rastin e paraqitjes së parë të këtyre reaksioneve (skuqja e lëkurës, ndryshimi i indit të lëkurës, shenjat tjera të ndjeshmërisë).

Naklofeni mund të zvogëlojë simptomat e infeksionit (për shembull, kokëdhimbjen, temperaturën e lartë) dhe për këtë arsye mund të pengojnë zbulimin e infeksionit. Nëse nuk ndiheni mirë dhe duhet të vizitoni mjekun, mos harroni të tregoni se trajtoheni me Naklofen.

Pacientët e moshuar

Efektet anësore, posaçërisht ato gastrointestinale mund të paraqiten shpesh tek njerëzit e moshuar.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barnat që merren pa recetën e mjekut.

Naklofen mund të ketë ndërveprim me disa medikamente tjera, ndërsa efekti i Naklofenit ose medikamenteve tjera mund të rritet ose të zvogëlohet. Kjo ndodh me:

- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e problemeve mendore (litiumi),
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e problemeve të zemrës (digoksini),
- medikamentet ujore (diuretikët),
- medikament që përdoret për t'i parandaluar ose trajtuar infeksionet e traktit urinar (trimethoprim),
- medikamentet të cilat përdoren për lehtësimin e dhimbjeve (acidi acetilsalicilik dhe medikamentet josteroide anti-inflamatore të tjera),
- medikamentet të cilat përdoren për zbërthimin e përgjigjes imune (ciklosporina, tacrolimus),
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e kancerit (metotreksati),
- medikamentet për shtypjen e lartë të gjakut (antihipertenzivët),
- medikamentet të cilat përdoren për ta reduktuar inflamacionin (kortikosteroidët),
- medikamentet për parandalimin e kuagolimit të gjakut (antikoagulantët dhe antitrombocitët),
- medikamentet për depresion (grupi antidepressantë i quajtur frenuesit e rimarrjes së serotoninës),
- medikamentet për diabet (antidiabetikët),
- disa medikamente të cilat përdoren për trajtimin e infeksionit (antibiotikët kinolonik),
- medikamentet për trajtimin e epilepsisë (fenitoini),
- medikamentet të cilat përdoren për të rregulluar nivelet e kolesterolit (kolestipoli dhe kolestimina),
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e infeksioneve të kërpudhave (vorikonazoli),
- medikamentet që përdoren për trajtimin e cermës (sulfonpirazon, probenecidi).

Marrja e Naklofen me ushqim dhe pije

Shtatzënia, gjdhënia dhe fertiliteti

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Nëse ju jeni shtatzënë ose ushqeni me gji, mendoni se jeni shtatzënë ose planifikoni të keni fëmijë, pyetni mjekun tuaj për këshilla para se të filloni të merrni këtë medikament.

Shtatzënia dhe të ushqyerit me gji

Naklofen mund të ndikojë negativisht në shtatzëni dhe/ose në zhvillimin e embrionit /fetusit. Disa të dhëna tregojnë se lëndimet ose malformimet fetale mund të paraqiten në shtatzëninë e hershme. Gjatë

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

gjashtë muajve të parë; të shtatzënisë, mjeku do të përshkruajë këtë mediakament vetëm nëse kjo është e domosdoshme. Në këtë rast ose nëse provoni të mbeten shtatzënë derisa ju trajtoheni me Naklofen, doza duhet të mbahet sa më e ulët dhe kohëzgjatja e trajtimit sa më e shkurtër.

Përdorimi i Naklofenit në tremujorin e fundit të shtatzënisë mund të çojë deri te abnormaliteti dhe mosfunksionimi i organeve të caktuara (çrregullimet e zemrës dhe enëve të gjakut, çrregullimet e veshkave, çrregullimet e koagulimit të gjakut, problemet gjatë lindjes). Prandaj Naklofen nuk guxon të përdoret gjatë tremujorit të fundit të shtatzënisë (shih nën seksionin Mos e merrni Naklofen).

Nuk duhet të ushqeni me gji gjatë trajtimit me Naklofen.

Fertiliteti

Si edhe NSAID tjerë, diklofenak, substanca aktive e Naklofen mund të vështirësojë përpjekjet për shtatzëni. Kjo është reverzibile për pengimin e medikamentit. Duhet të informoni mjekun tuaj nëse planifikoni të mbeten shtatzënë ose nëse ju keni problem të mbeten shtatzënë.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna nëse Naklofen ka efekt të moderuar në aftësinë për të drejtuar automjete ose për të përdorur makineri. Nëse ju keni marramendje, çrregullimin e të pamurit, përgjumësi dhe/ose efekte tjera të sistemit nervor, mos drejtoni automjetin ose mos përdorë makinat e rrezikshme.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Naklofen

Naklofen përmban benzil alkool, propilen glikol, metabisulfit natriumi dhe natrium.

3 ml (1 ampulë) tretësirë e Naklofenit përmban 120 mg benzil alkool. Benzil alkooli mund të shkaktojë reaksione alergjike. Kërkoni këshilla nga mjeku apo farmacisti i juaj nëse jeni shtatzënë ose ushqeni me gji, apo nëse keni sëmundje të mëlçisë ose veshkave. Kjo është për shkak se në trupin tuaj mund të akumulohen sasi të mëdha të benzil alkoolit dhe të shkaktojnë efekte anësore (të quajtura "acidozë metabolike").

Ky produkt mjekësor përmban 630 mg propilen glikol në 3 ml tretësirë për injeksion (1 ampulë).

Metabisulfitet mund rrallë të shkaktojnë reaksione serioze mbindjeshmërisë dhe bronkospazmë.

Ky produkt mjekësor përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për dozë, që do të thotë se në thelb është 'pa-natrium'.

3. SI TË MERRET NAKLOFEN

Gjithmonë merrni Naklofen saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Medikamentin do të ju jap mjeku ose infermierja.

Doza e zakonshme për të rriturit është 1 ampulë, një deri dy herë në ditë; doza e mirëmbajtjes është e ngjajshme. Injeksioni duhet t'i jepet thellë në muskul.

Në kolika renale, një injeksion i dytë mund të jepet 30 minuta pas injeksionit të parë.

Injeksione përdoren për të trajtuar sëmundje akute. Sa më shpejt të jetë e mundur, trajtimi duhet të vazhdojë me tableta, kapsula ose supozitorë.

Ky bar duhet t'i jepet me kujdes në pacientët me pamjaftueshmëri të veshkave ose në mosfunksionim të mëlçisë. Është e rekomanduar për të përdorur diklofenak natriumi në doza efektive më të ulëta.

Nëse keni përshtypjen se efekti i barit është shumë i fortë ose shumë i dobët, bisedoni me mjekun tuaj.

Nëse merrni Naklofen më shumë se ç'duhet

Kur pacientët janë trajtuar vetëm me injeksione, nuk pritet mbidozim.

Mjeku juaj do të vendosë në lidhje me madhësinë e dozave dhe kohëzgjatjen e trajtimit.

Nëse merrni Naklofen më shumë se sa që duhet, kjo më së shpeshti shkakton rritjen e efekteve anësore, në traktin gastrointestinal, në veshka, mëlçi dhe sistemin nervor qendror.

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Nëse harroni të merrni Naklofen

Mos merrni dozë të dyfishtë për të kompenzuar dozën e harruar.

Mjeku juaj do të vendosë në lidhje me frekuencën e injeksioneve. Nëse, për çfarëdo arsye, ju nuk keni marrë një injeksion të planifikuar, informoni mjekun tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

Nëse e ndërprisni marrjen e Naklofen

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Naklofen mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

Disa nga efektet anësore mund të jenë serioze.

Ndaloni të merrni Naklofen dhe informoni mjekun tuaj nëse vëreni:

- Spazmë të butë dhe ndjeshmëri të stomakut, menjëherë pas fillimit të trajtimit me Naklofen dhe gjakderdhje rektale ose të përcjellë me diarre të gjakosur zakonisht në afatin prej 24 orë nga paraqitja e dhimbjes abdominale (frekuenca nuk është e njohur, nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave në dispozicion).
- Dhimbje gjoksi, që mund të jetë shenjë e ndonjë reaksioni alergjik potencialisht serioz të quajtur sindroma Kounis.

Efektet anësore më shpesh të vërejtura janë të natyrës gastrointestinale.

Shpesh (mund të ndikojë tek 1 nga 10 persona):

- të përziera, të vjella,
- diarrea,
- dhimbje në stomak,
- problemet e tretjes menjëherë pas ushqimit (dispepsia),
- fryrje,
- humbje e oreksit,
- kokëdhimbja, vertigo, marramendja,
- enzimet e shtuara të mëlçisë,
- skuqje e lëkurës,
- reaksioni në vendin e injeksionit, dhimbje, induracion (ngurtësim).

Periodikisht (mënd të ndikojë në 1 nga 100 persona):

- kapsllëk.

Rrallë (mund të ndikojë në 1 nga 1,000 persona):

- reaksionet e ndjeshmërisë (vështirësitë në frymëmarrje ose vështirësitë në qëllitje (bronhospazëm), tension i ulët i gjakut, shoku),
- përgjumësi, lodhje,
- astma (përfshirë vështirësitë në frymëmarrje),
- inflamacioni i membranës së stomakut (gastritis), jashtëqitje e zezë (melena), të vjella gjaku nga lukthi ose ezofagu (hematemeza), gjakderdhje, diarrea e gjakosur, ulçera gastrointestinale ose perforacioni,
- verdhëza,

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- çrregullime të prera të funksionit të mëlçisë, vdekja e qelizave të mëlçisë (nekroza hepatocelulare),
- pengimi i rrjedhës së tëmthit (holestaza),
- koshere,
- mbajtja e lëngjeve dhe ënjtje (edemi),
- nekroza në vendin e injeksionit (vdekja e indit).

Shumë rrallë (mund të ndikojë në 1 nga 10,000 persona):

- ndryshimi i pasqyrës së gjakut (anemia, trombocitopenia, leukopenia dhe agranulocitoza),
- ënjtje lokale e cila zhduket për 24 orë, përfshirë ënjtjen e fytyrës (angioedema),
- dezorientimi, depresioni, pagjumësia, ankthi, nervozizëm, reaksionet psikotike,
- ndezje, çrregullimet e të mbajturit në mend, konvulsionet, anksioziteti, tremori, inflamacioni i membranës së trurit, çrregullimet e shijes, ngjarjet cerebrale,
- çrregullimet e të pamurit, të pamurit e dyfishtë ose paqartë,
- tingëllima në veshët, dëmtimi i nuhatjes,
- ndjenjë e pakëndshme e rrahjes së detyrueshme të zemrës (palpitacionet), dhimbje në gjoks, isnuficienca e zemrës, sulmi në zemër, presioni i lartë i gjakut, inflamacioni i enëve të gjakut,
- pneumonia,
- inflamacioni i zorrës së trashë (koliti hemoragjik jospecifik, përsëritja ose përkeqësimi i kolitisit të ulçerës ose sëmundjes së Kronit),
- inflamacioni i membranës të mukozës së gojës (stomatiti ulçerativ) inflamacioni i gjuhës (glositis), ulçera e grykës strukturat intestinale sipas llojit të diafragmës,
- pezmatimi i pankreasit (pankreatiti),
- dështimi akut i mëlçisë (hepatitisi fulminant) dhe dështimi i mëlçisë,
- reaksionet buloze, përfshirë sindromin Stevens-Johnson (pezmatimi i rëndë i skuqjes në lëkurë, gojë, sy dhe organet gjenitale) dhe nekroliza epidermale toksike (e rëndë, skuqje ekstensive lëkurës, skuqje dhe gërvishjet e lëkurës),
- ekcemi, skuqje, inflamacioni i lëkurës (dermatitis), humbje e flokëve, ndjeshmëria ndaj dritës (fotosenzitivitet), gjakderdhje në lëkurë dhe nën lëkurë (purpura, purpura alergjike), kruajtje,
- dështimi kronik i veshkave, dështimi akut i veshkave, gjak në urinë (hematuria), çrregullimi i traktit urinar (nefritisi interstiv, sindromi nefrotik, nekroza renale papilare, proteinuria),
- abscess në vendin e injeksionit.

Nuk është e njohur (nuk mund të vlerësohet në bazë të dhënave në dispozicion):

- dëmtimi i indit në vendin e injeksionit.

Medikamentet si Naklofeni mund të lidhen me rrezikun e vogël të shtuar nga sulmi në zemër (infarkti i miokardit) ose sulmi në tru.

Paraqitja e efekteve anësore

Nëse keni efekte anësore, bisedoni me mjekun tuaj ose infermieren. Kjo përfshin efektet anësore eventuale të cilat nuk janë dhënë në këtë udhëzim. Gjithashtu, mund të lajmëroni efektet anësore drejtpërdrejtë përmes sistemit nacional për raportim.

Me paraqitjen e efekteve anësore, mund të ndihmoni në ofrimin e më shumë informacioneve për sigurinë e këtij medikamenti.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET NAKLOFEN

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

1.3.1	Diclofenac
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Mos e përdorni Naklofen pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Të ruhet në temperaturë deri në 25°C.
Ruajeni në paketim origjinal të mbrojtur nga drita.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta mbrojtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Naklofen

Substanca aktive është: diklofenak natrium.

1 ml tretësirë për injeksion përmban 25 mg diklofenak natriumi.

3 ml tretësirë për injeksion (1 ampulë) përmbajnë 75mg diklofenak natriumi.

Përbërësit e tjerë janë: alkool benzilik, propilen glikol (E1520), metabisulfit natriumi (E223), hidroksid natriumi (E524), ujë për injeksion. Shih pjesën 2 "Naklofen përmban benzil alkool, propilen glikol, metabisulfit natriumi dhe natrium".

Si duket Naklofen dhe përbërja e paketimit

Tretësira për injeksion është një tretësirë e qartë, pa ngjyrë me pak ngjyrë të verdhë të lehtë.

Ajo është në dispozicion në kutitë me 5 ampula prej 3 ml tretësirë për injeksion.

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet me recetë të mjekut.

Ky produkt mjekësor mund të përdoret vetëm në institucione të shëndetit publik, ku aktiviteti mjekësor kryhet nga persona fizikë dhe ligjorë.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

www.krka.si

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në

06/2022

Informacionet në vazhdim janë të dedikuara vetëm për punëtorët medicinal ose shëndetësor:

Naklofen® 75 mg/3 ml tretësirë për injeksion

diklofenak natriumi

Inkompatibiliteti

Nuk rekomandohet që ky medikament të përzihet me ndonjë medikament tjetër në shiringën e njëjtë.